

QENDRA PËR MENAXHIM ME NDRYSHIMET

PREZANTOHET FUNKSIONIMI I SHTËPIVE TË PENSIONISTËVE



Më 7 nëntor 2018, para kryetarëve të shoqatave anëtare të LSHPM-së, Qendra për menaxhim me ndryshimet kishte prezantim interesant të analizës së funksionimit të shtëpive dhe banesave të pensionistëve në Maqedoni, me të cilat menaxhon FSPIM, porositisë i të cilës është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të Maqedonisë. Në fillim të prezantimit, të pranishmit i përshëndeti Stanka Trajkova, sekretare e KE të LSHPM dhe nënkryetare e Këshillit për siguri sociale që punon në kuadër të MPPS-së, duke shprehur kënaqësinë që Qendra për menaxhim me ndryshimet do të prezantojë pikëpamjet edhe para LSHPM-së. Të pranishmit nga MPPS dhe kryetarin e LSHPM, Dragi Argirovski i përshëndeti për zëmërisht drejtoresha e Qendrës Neda Maleska - Saçmaroska. Pastaj, Stanka Trajkova

theksoi se Prezantimi është interesant për shkak se në vendin tonë çdo ditë e më shumë kemi numër më të madh të popullatës së moshuar, ndërsa pensionistët janë shfrytëzues të shtëpive të pensionistëve dhe mund të japin mendimin e tyre për zgjidhjen e këtij problemi, që edhe deri më tani LSHPM e ka ngritur në shumë nivele sepse prioritet kryesor edhe tek ne edhe në Bashkimin Evropian dhe i Organizatës Botërore të Shëndetësisë është lufta kundër përjashtimit social të personave të moshuar dhe avancimi i kualitetit të jetës së tyre. Pas asaj drejtoresha e Qendrës Neda Maleska-Saçmaroska kishte fjalim hyrës për projektin ku prezantoi qëllimet e analizës si dhe propozimet që kanë dalë nga e njëjta, dhe tha se në bazë të të dhënave të fituara në terren nëpër gjithë Maqedoninë është vë-

tetuar se funksionimi i shtëpive dhe banesave të pensionistëve në Republikën e Maqedonisë, me të cilat menaxhon FSPIM, është vlerësuar me notën 3, por përshtypja e përgjithshme është se gjendja faktike është nën këtë notë. Këto shtëpi dhe banesa, me të cilat menaxhon FSPIM janë në gjendje të keqe për shkaqe të shumta, ndërsa shkaku kryesor është qiraja e ulët, e cila është e ndryshme varësisht prej qyteteve, dhe në shumicën e tyre nuk ka edhe menaxhues. Si rezultat i analizës janë ofruar 4 modele për përmirësimin e gjendjes së bashku me anët e tyre të mira dhe të dobëta, ndërsa cili model do të zgjedhet, varet nga institucionet kompetente për atë problematikë. Gjatë asaj janë shfrytëzuar përvojat botërore dhe përvojat e ish vendeve socialiste. Pastaj modellet janë arsyetuar edhe në pikëpamjen juridike dhe financiare.

Në diskutimin e tij, kryetari i LSHPM-së, Dragi Argirovski theksoi se zgjidhja është në ndërtimin e shtëpive të reja të pensionistëve sepse 483 shtretër nuk janë asgjë në relacion me 320000 pensionistë. Duhet të ndërtohen edhe shtëpi të pensionistëve dhe shtëpi të pleqve për të gjithë pensionistët, e posaçërisht për ata me pensione të ulëta, sepse 30 vjet nuk është shtuar as një shtrat. Është shumë me rëndësi që MPPS ngritë këtë çështje që është shumë me rëndësi për pensionistët. (K.S.Andonova)



Ekskursion dyditor në Malin e Zi

Në bashkëpunim me sektorin biznes privat, Shoqata e Pensionistëve nga Saraji, më 20 dhe 21.10.2018, organizoi ekskursion dyditor në qytetin e Ulqinit dhe Tuzit në Malin e Zi. Ekskursioni ishte financiarisht i mbështetur nga Kompania "Dauti Komerc" dhe Fondacioni "Albiz", të dyja nga Komuna e Sarajit. Në ekskursion morën pjesë 101 pensionistë nga Shoqata prej të cilëve 10 pensionistë nga Aktivi i pensionistëve pranë shoqatës. Ekskursioni ishte i organizuar dhe i realizuar në rendin më të mirë të mundshëm. Me vizitë të biznes-objektit të Kompanisë "Dauti Komerc" në Kosovë, u hëngër drekë në restorantin "Evropa 92" dhe kishte kafe pauzë. Në orët e mbrëmjes u bë arritja në qytetin e Shkodrës, ku u vizitua Xhamia "Perash". Me arritje në Ulqin, në orët e mbrëmjes, pas darkës në restorantin "Kallaba" pensionistët u vendosën në hotelin luksoz "Metropol". Të nesërmen, udhëtimi u vazhdu për në qytetin e Tuzit në rreth 10km nga Podgorica. Në qytetin bregdetar Bar, u vizitua Xhamia "Selimije" e ndërtuar nga agjencia shtetërore turke "TIKA", e lëshuar në përdorim në vitin 2014. Arritja në qytetin e Tuzit u bë rreth orëve të pasdites. U vizitua objekti i kompanisë "Dauti Komerc", ku nga ana e kompanisë secilit pensionist iu dha nga një dhuratë modeste. Gjatë kthimit pranë bregut të Lumit të Shkodrës, në orët e mbrëmjes, pensionistët arritën në Kukës. Gjatë tërë kohës pjesëmarrësit e ekskursionit ishin të befasuar nga organizimi i mirë, shërbimi i shkëlqyer dhe nga e gjithë ajo që panë. Ekskursioni do të mbetet gjatë në kujtimet e të gjithëve, ndërsa edhe më shumë që rreth 80% të pjesëmarrësve për herë të parë ishin në vizitë të këtyre qyteteve. Për organizatorët çdo nder. Pjesëmarrësit pensionistë të ekskursionit veçanërisht ishin falënderues për këtë gjest human që ua zbukuroi jetën në stinë e tretë të moshës. (Baki Bakiu)

Pensionistët që marrin vetëm pensione, s'do të regjistrohen në DAP

Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë në kuadër të aktiviteteve të saj, mes tjerash është kujdesur për realizimin e të drejtave dhe obligimeve të pensionistëve që dalin nga rregullativa ligjore e tatimeve, e posaçërisht t'u ndihmohet numrit më të madh të pensionistëve për t'u liruar nga obligimi për regjistrim në sistemin e-Tatimi personal i të ardhurave.

Me sjelljen e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për tatimin personal të të ardhurave ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 190/2017) është caktuar se Paraqitjen vjetore të tatimeve të obliguesve tatimor për pagim të tatimit personal të të ardhurave do

ta përpilojë Drejtoria për të ardhura publike dhe do ta parashtrojë për vërtetim të të njëjtës në formë elektronike.

Prej këtui doli edhe nevoja për regjistrim në sistemin e-Personal, për çka Lidhja jep mbështetje të madhe në zbatimin e kësaj dispozite ligjore, por kjo të vlejë vetëm për obliguesit tatimor, përfshirë edhe pensionistët, të cilët krahas pensionit realizojnë edhe të ardhura shtesë. Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë ka bërë analizë për arsyetimin dhe konstaton se prej rreth 310.000 pensionistëve, mbi 200.000 nuk kanë të ardhura shtesë në asnjë bazë tjetër përveç pensionit dhe nuk është e arsyeshme

që ata të regjistrohen në sistemin e-Tatimi personal i të ardhurave, nuk do të ketë asnjë efekt, vetëm do të krijohen vështirësi, shpenzime shtesë në përmbushjen e këtij obligimi. Nga ana tjetër, mes atyre që nuk kanë të ardhura shtesë, shumica janë që jetojnë në mjedise rurale, janë të sëmurë dhe persona të shtyrë në moshë. Për shkak të shkaqeve të lartpërmendura Lidhja ka reaguar në kohë, dhe para disa kohe ka parashtruar edhe KËRKESË deri te Ministria e financave—Sektori për tatime dhe politikë doganore, me të cilën ka kërkuar që nga ky obligim të lirohen të gjithë pensionistët të cilët përveç pensionit nuk marrin asnjë të ardhur tjetër. (M.S)

LIDHJA E SHOQATAVE TË PENSIONISTËVE TË QYTETIT TË SHKUPIT

Turniri tradicional i shahut "13 nëntori"

Me rastin e ditës së çlirimit të Qytetit të Shkupit - 13 Nëntori, për të gjashtëmbëdhjetën herë u mbajt turniri tradicional i shahut "13 Nëntori" në organizim të LSHP të Qytetit të Shkupit, ndërsa nën kujdesin e kryetarit të qytetit, Petre Shilegov. Në hapjen dha fjalë kryetari i KE të SHP të Qytetit të Shkupit, Metodija Navkovski, ku mbi të gjitha tha: "Dërgoj përshëndetje deri tek shoqatat e Qytetit të Shkupi dhe ekipet e tyre garuese të shahut. Ky turnir është i themeluar që nga viti 2003, që do të thotë se ky është turniri i gjashtëmbëdhjetë në vazhdim. E shfrytëzoj rastin t'ia uroj festën Qytetit të Shkupit dhe organeve të vetëqeverisjes lokale në qytet. Përshëndetje të veçantë dërgoj deri tek kryetari i qytetit Petre Shilegov dhe deri tek kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupi, Ljubica Jançeva të cilët për arsye të obligimeve zyrtare nuk mundën të marrin

pjesë. Veçanërisht e përshëndes pjesëmarrjen e kryetarit të LSHPM, Dragi Argirovski, kryetarit të KE të LSHPM, Saltir Karoski dhe kryetarët e shoqatave të pensionistëve të Shkupit ekipet e të cilave garojnë në këtë atmosferë të mrekullueshme. Për turnirët e mbajtur deri më tani do të lëshojmë një Biltën të ilustruar. Të gjithë pjesëmarrësve dua t'iu uroj lojë të mirë dhe shoqëri me disponim të mirë dhe të bashkëpunojmë në shumë aktivitete të ngjashme për shumë vjet". Pastaj, ndaj garuesve dhe prezencës iu drejtua kryetari i LSHPM-s Dragi Argirovski.

"Pensionistë të dashur, më lejoni, që me kënaqësi të madhe të ju uroj që sot të keni një ditë të bukur. Ky turnir tradicional i qytetit të Shkupit çdo herë ka qenë i mbështetur nga LSHPM. E mbaj mend, kur u bëra kryetar i LSHPM në vitin 2011 edhe atëherë e ki-

sha nderin dhe kënaqësinë të bëj hapjen e këtyre takimeve. Atë vit kemi festuar 65 vjet organizim pensional në Maqedoni. Ju jeni sportistët dhe njerëzit e përzgjedhur të cilët gjithmonë keni qenë ndër më të mirët. Pa shpirtin sportiv, pa atë që është karakteristike e lojtarëve të shahut, mjeshtër të atyre 46 poleve, nuk është e mundur që të arrihen rezultate edhe në fusha tjera siç janë shoqëria dhe bashkësia për të cilat LSHPM më së shumti qëndron. Ju përshëndes shumë dhe e shpalli këtë turnir të gjashtëmbëdhjetë "13 Nëntori" të hapur", tha mes të gjithave kryetari Argirovski.

Pastaj filloi turniri, i cili zhvillohej sipas Rregullores për gara sportive të LSHPM. Në turnir morën pjesë ekipe mashkullore nga shoqatat pensioniste: Butel, pensionistët e ushtrisë, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Ilinden, Kisela Voda, OVR i RM-s, Saraj, Solidarnost-



Aerodrom, Taftalixhe, Qendër dhe Çair, ndërsa me ekipet femërore shoqatat pensioniste: Gjorçe Petrov, Solidarnost-Aerodrom dhe Kisela Voda. Vendin e parë, të dytë dhe të tretë në kategorinë e meshkujve e morën ekipet nga: Qendra, Buteli dhe Ilinden. Ndërsa radhitja e ekipeve të kategorisë së femrave ishte: Gjorçe Petrov, Solidarnost-Aerodrom dhe Kisela Voda. Pas shpërndarjes së diplomave u dhuruan falënderime për shoqatat. Falënderim i veçantë iu dhurua kryetarit të LSHPM, Dragi Argirovski për përkrahjen shumëvjeçare dhe bashkëpunimin me LSHP të Qytetit të Shkupit. Pastaj takimi vazhdoi me shoqërim të përbashkët. (Ilija Gligorov)